



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 897 Prot.

Tiranë, më 03.06 .2020

UDHËZIM

Për punonjësit e terrenit gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19

Drejtuar: Drejtorisë e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit

Për dijeni: Drejtorisë së Financës dhe Projekteve

Për shkak të pandemisë të shkaktuar nga COVID-19, INSTAT qëndër, Zyrat Rajonale Statistikore dhe punonjësit e terrenit (anketuesit, kontrollorët e terrenit dhe teknikë të specialiteteve të ndryshme) për kryerjen e aktiviteteve statistikore, të zbatojnë hapat e mëposhtëm gjatë punës në terren:

1. Personat përgjegjës për anketat të sigurojnë mbajtjen dhe ruajtjen e evidencave të kontakteve dhe punës së kryer në terren.
2. Punonjësit e terrenit gjatë kryerjes së aktivitetit statistikor të:
 - 2.1 Të pajisen me mjete mbrojtëse maska dhe doreza.
 - 2.2 Të aplikojnë larjen e duarve dhe/ose përdorimin e dezinfektantëve;
 - 2.3 Të vendosin maska mbrojtëse dhe doreza, si dhe të përdorin shami letre për higjenën e hundëve;
 - 2.4 Të mos përdorin mjetet e punës së njëri-tjetrit;
 - 2.5 Të respektojnë praktikat e etiketës respiratore, kollitjes e teshtitjes;
 - 2.6 Të respektojnë masat e distancimit social dhe fizik duke ruajtur distancën të paktën 2 (dy) metra gjatë kryerjes së detyrave;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al




REPUBLIKA E SHQIPËRIË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- 2.7 Nëse kanë pasur kontakt të ngushtë me një person pozitiv me COVID-19, të qëndrojnë në vetëkarantinim dhe të njoftojnë mjekun e familjes dhe eprorin direkt;
- 2.8 Nëse shfaqin shenja klinike, të qëndrojnë në shtëpi, të vetëkarantinojnë, të njoftojnë personin përgjegjës për anketën, të monitorojnë shenjat klinike dhe për çdo shqetësim të njoftojnë mjekun e familjes ose numrin 127 të urgjencës;
3. Ngarkohet Drejtoria e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit për vënien në dijeni të stafit të terrenit dhe për ndjekjen e zbatimit për sa parashikohen në këtë udhëzim.
4. Moszbatimi i këtij udhëzimi nga personat e ngarkuar, përbën shkelje administrative dhe ndaj tyre merret masë disiplinore në përputhje me normat ligjore në fuqi.
5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR I BORDIT DREJTUES

ELSA DHULI



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al